



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Nr. Serie 15

LEJE  
PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR  
Nr. prot. 10/11 datë 22/04 2020

Miratuar me :  
VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR  
Nr. 02, datë 16/04/2020

Emri i subjektit: "Kurum International" sh.a  
I REGJISTRUAR ME KËTO TË DHËNA: "KURUM INTERNATIONAL" SH.A, me  
NIPT K02727230T

Baseni Ujor: VJOSË  
Qarku: VLORË

Bashkia/Komuna: FINIQ

Koordinatat: X 515885.33 Y 4420365.2 Z 151m

Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Prodhim Hidroenergjie

Prujta mesatare: 18.3 m3/s

Prujta ekologjike: 0.5 m3/s

Sasia e ujit që jepet në përdorim: 25 m3/s

Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka) : 25 m3/s dhe vendi ku rrjedha e kthyer do të  
shkarkohet Lumi Bistrica

Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura: Lumi Bistrica

Sipërfaqja e tokës me të cilën lidhet përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes): s'ka (ha)

Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë : Të ruhet në siguri të lartë diga e Veprës së marrjes së  
Hidrocentralit Bistrica 1, me qëllim parandalimin e katastrofave; Të menaxhohet në mënyrë  
optimale rezerva ujore, me qëllim parandalimin e përmbytjeve në rrjedhën e poshtme të  
Lumit Bistricë; Të respektohet në mënyrë strikte sasia e rrjedhës ekologjike dhe e nevojave të  
komunitetit për ujitje apo blegtori.

Periodha e vlefshmërisë: 5 vjet



## Kushtet e Lejes

1. Të respektohet qëllimi për të cilin jepet kjo leje;
2. Te respektohen kushtet higjieno sanitare dhe të mbrojtjes së mjedisit përreth;
3. Përdoruesi i ujit është i detyruar të vendosë matës ujit me shpenzimet e veta sipas rregullave që vendosin autoritetet e ujit;
4. Në rastet kur uji përdoret si produkt ushqimor, procedurat e prodhimit duhet të jenë konform rregullave të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujerave;
5. Burimi ujqor të shfrytëzohet nga zotëruesi i lejes;
6. Brenda 2 muajve nga pajisja me leje, subjekti duhet të fillojë veprimtarinë për të cilën është pajisur me leje;
7. Leja nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër pa miratimin e organeve kombëtare të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
8. Të mos kryhen veprime që sjellin drejtpërdrejte ose si pasojë, dëmtimin e burimit ujqor;
9. Subjekti të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse;
10. Subjekti të paraqesë çdo informacion, dokument dhe të japë çdo shpjegim lidhur me mënyrën e përdorimit të burimit ujqor;
11. Për shkeljen e kushteve të lejes, do të merren masa në përputhje me Kreun XIX të Ligjit nr. 111/2012;
12. Zotëruesi i lejes paguan shpenzimet administrative dhe tarifën për ujin e shfrytëzuar, bazuar në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

## Ndryshimi ose anulimi i lejes

Kjo leje mund të ndryshohet pjesërisht ose të anulohet plotësisht, para mbarimit të afatit të përcaktuar, kur:

1. Përfutuesi i lejes shkel njërin nga kushtet e parashikuara me sipër;
2. Organi kompetent për nxjerrjen e lejes bën azhurmimet përkatëse lidhur me burimin konform ndryshimit të planeve të burimeve ujore, ndryshim i cili prek edhe burimin ujqor, objekt i kësaj leje;
3. Kushtet e dhënies së lejes kane ndryshuar;
4. Burimi ujqor është drejt shterimit;
5. Aktiviteti që ushtrohet, bazuar në lejen e dhënë, është shkak i ndotjes së burimit ose mjedisit;
6. Në qoftë se për shkak të forcave madhore ndodhin ndryshime në prurjen, cilësinë, kufijtë e burimit, etj, dhe këto ndryshime sjellin pamundësinë e përdorimit të tij nga zotëruesi i lejes, ky i fundit ka të drejtë t'i drejtohet organit kompetent, që i ka dhënë lejen, për ta anuluar atë;
7. Ka ndryshime të legjislacionit përkatës në fushën e ujerave dhe që prekin drejtpërdrejtë kushtet e kësaj leje.